



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 57, datë 02.12.2022

PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË ZNJ. MARJANA SEMINI TUTULANI NË VENDIN VAKANT PËR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË DATËN 16.01.2022

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Sokol Binaj	Kryetar
Altin Binaj	Anëtar zëvendësues
Elsa Toska	Anëtare
Anila Leka	Anëtare
Edlira Petri	Anëtare
Enton Dhimitri	Anëtar
Genti Xholi	Anëtar zëvendësues
Etien Kapo	Anëtar
Klodiana Veizi	Anëtare relatore

Asistuar nga sekretare Fabiola Muhameti, me praninë e përfaqësuesit të Avokates së Popullit, z. Enio Haxhimihali, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve: zonjës Mimoza Arbri, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit, në mbledhjen e datës 02.12.2022, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATES: Marjana Semini Tutulani

OBJEKTI: Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së Znj. Marjana Semini Tutulani, në vendin vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 16.01.2022.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoji relatimin e anëtares së KED-it, zonjës Klodiana Veizi, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, z. Enio Haxhimihali, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në përfundim të procedurës së verifikimit për këtë kandidatë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 52, datë 15.11.2022 ka vendosur “*Lejimin e kandidimit të kandidatës Marjana Semini Tutulani, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 16.01.2022*”, vakancë e plotë, e krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit Altin Binaj.
2. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8577/2000 dhe të ligjit nr. 115/2016, si edhe atyre të Kreut IV (pikat 27-38) të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “*Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, anëtarja e Këshillit, znj. Klodiana Veizi, në cilësinë e relatores të vendit vakant të cituar më lart, ka realizuar veprimet përgatitore të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, njëkohësisht me procedurat e verifikimit të tyre.
3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi shqyrtoi procedurat e ndjekura gjatë veprimeve përgatitore nga relatorja dhe plotësinë e dokumentacionin të paraqitur për vlerësim nga secili kandidat, dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për përgatitjen e dokumentacionit të kandidatëve, me vendimin e datës 21.11.2022 ka vendosur fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të përfundimit të mandatit, të gjyqtarit Altin Binaj, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 16.01.2022.
4. Bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidatja Marjana Semini Tutulani në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, anëtarja e Këshillit, relatore e vendit vakant në të cilën kjo kandidatë ka paraqitur kandidaturën e saj, hartoi relacionin përkatës për gjetjet në procedurën e përzgjedhjes dhe të vlerësimit të këtij kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, i cili i është njoftuar kandidatës.
5. Kryetari i Këshillit ka thirrur mbledhjen e Këshillit në datën 22.11.2022, ora 15:00, për zhvillimin e intervistës dhe testimin e njohurive të gjuhës së huaj me kandidatët e lejuar. Kandidatja Marjana Semini Tutulani ka përzgjedhur të intervistohet në gjuhë të huaj Angleze, për pasojë u vendos marrja e ekspertit të gjuhës së huaj angleze.
6. Intervista mbi motivimin e kandidimit me kandidaten Marjana Semini Tutulani u zhvillua në mbledhjen e Këshillit të datës 30.11.2022.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

7. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidatja Marjana Semini Tutulani në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej saj sipas kërkesave të Këshillit, si edhe shkresa dhe të

dhëna të tjera të kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Këshilli ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatës Marjana Semini Tutulani për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara:

- a) në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës;
- b) në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të plotësuara, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në këto dispozita, me kriteret e përgjithshme të vlerësimit të parashikuara në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016;
- c) në detajimin e mëtejshëm të kriterëve ligjore të posaçme dhe të përgjithshme të vlerësimit dhe përcaktimin më të hollësishëm të peshës specifike të tyre në pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të treguar në Kreun II, në Kreun V dhe në Shtojcën 1 të Vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
- ç) në shpjegimet e hollësishme lidhur me metodologjinë mbi të cilin bazohet në vlerësimi dhe caktimi i pikëve të miratuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”.

A. Meritat profesionale – Historiku Arsimor dhe Profesional

Vjetërsia në profesion

- 8. Në shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi “*Vjetërsia në profesion*”. Ndërkohë që, sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a pika 2 shkronja “a” të ligjit nr. 8577/2000, përbën kusht lejimi kandidimi që kandidati të ketë së paku 15 vjet përvojë profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës (jurist) të nivelit të lartë në administratën publike.
- 9. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë kohëzgjatjen për më shumë se 15 vjet të këtyre fushave të përvojës profesionale të secilit kandidat, në maksimum deri në 4 pikë, sikurse orientohet në tabelën e përshkallëzuar të pikëzimit të vjetërsisë në profesion të treguar në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.
- 10. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Marjana Semini Tutulani ka ushtruar veprimtaritë profesionale si më poshtë:
 - a) *Pedagoge (Përgjegjëse/Drejtor), për periudhën 01.10.1997 e në vijim, pranë Shkollës së Magjistraturës.*
 - b) *Pedagoge, për periudhën 28.06.1991 – 01.10.1997, pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, Universiteti i Tiranës.*
 - c) *Asistente Pedagoge, për periudhën 01.09.1988 – 28.06.1991, pranë Fakultetit të Shkencave politike Juridike, Universiteti i Tiranës.*

11. Mbështetur në të dhënat e sipërcituara sipas germave “a”, “b” dhe “c”, rezulton se kandidatja Marjana Semini Tutulani, në momentin e përpilimit të relacionit të vlerësimit (datë 24.11.2022), ka gjithsej 34 vjet , 1 muaj e 23 ditë vjetërsi në profesion dhe përvojë.
Sipas përcaktimeve të nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përbën kusht lejimi kandidimi, përvoja profesionale si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, nëpunës (jurist) i nivelit të lartë në administratën publike, së paku 15 vjet. Vjetërsia e kandidates në referim të sa më sipër përlllogaritet si profesor dhe lektor i të drejtës 31 vite 5 muaj 7 dite, duke u perfshirë periudhat e punës të përcaktuara në gërmat “a” dhe “b” të pikës 6.
12. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “vjetërsia në profesion”, nisur nga ushtrimi i veprimtarive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 në një kohëzgjatje prej 31 vite 5 muaj 7 dite , vlerësoi znj. Marjana Semini Tutulani me **4 (katër) pikë**.

Historiku Arsimor

13. Në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.
14. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, të secilit kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.
15. Me qëllim të plotësimit të kriterëve të parashikuara nga pika 2 e nenit 7/a të ligjit 8577/2000, Këshilli vlerëson sipas pikës 3 shkronja d) e nenit 7/a të ligjit 8577/2000 edhe ecurinë e kandidatit gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8, e cila përlllogaritet sipas pikës 5 të VKM nr. 436, datë 3.6.2020, *“Përcaktimet e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në Institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”*.
16. Në bazë të certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës rezulton se ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare **9.75**.
17. Për sa më lart, nisur nga përlllogaritja e kryer nga Këshilli sipas të cilës nota mesatare e arritur nga kandidatja Marjana Semini Tutulani gjatë studimeve dhe diplomimit në

Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës është 9.75, për kriterin e vlerësimit “*historiku arsimor*”, Këshilli vlerësoi kandidaten me **2 (dy) pikë**.

Kualifikime Pasuniversitare

18. Në pikën 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe pikat 1 e 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi kualifikimet pasuniversitare. Ky kriter vlerëson llojin dhe nivelin e angazhimit të kandidatit në ndjekjen e veprimtarive të kualifikimit profesional që mundësojnë arritjen e një profesionalizmi më të madh në shërbim të ushtrimit të funksioneve dhe detyrimeve profesionale të tilla si, pasja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja e kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.
19. Referuar kritereve ligjore të vlerësimit dhe metodologjisë së pikëzimit, që gjejnë pasqyrim në mënyrë të detajuar në Shtojcën nr. 1 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kualifikimeve pasuniversitare, si një nga indikatorët me të cilët vlerësohet niveli profesional i kandidatëve, u janë caktuar në total 8 pikë.
20. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.
21. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidatja Marjana Semini Tutulani ka këto tituj dhe grada shkencore, në rend kronologjik si vijon:
 - Ka ndjekur studimet universitare në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në periudhën 1984-1988 dhe është diplomuar “Jurist”; nota mesatare e studimeve rezulton **9.75**.
 - Ka ndjekur studimet pasuniversitare dhe në nëntor 1994, merr gradën shkencore “Doktor në Drejtësi”.
 - Në Mars 1999, merr titullin shkencor “Profesor i Asociuar” .
 - Në nëntor 2009, merr titullin shkencor “Profesor”, pranë Universitetit të Tiranës.
22. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Caktimin e Pikëve udhëzohet se, duke qënë se znj.Mariana Semini Tutulani mban titullin “Profesor”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Marjana Semini Tutulani me **6 (gjashtë) pikë**.

23. Për treguesin e vlerësimit "*Trajnimet e tjera*", vlerësohen veçanërisht trajnime me një kohëzgjatje minimale 2 javore, duke mbajtur parasysh edhe numrin, llojet, tematikat dhe kohëzgjatjet e përgjithshme të trajnimeve në fusha të caktuara, institucionet trajnuese, si dhe nëse trajnimet janë shoqëruar me një certifikatë vlerësimi. Lidhur me këtë kriter vlerësimi, Këshilli mund të caktojë deri në 2 pikë.
24. Nga akti dokument i jetëshkrimit të kandidatit që ndodhet në dosjen e kandidimit rezulton se kandidatja Marjana Semini Tutulani, deklaron se ka kryer këto trajnime:
- Periudha: 2001-20002, specializimi në kuadër të Projektit "Toëaed a Model of Judge", Bologna Italy.
 - 9-30 maj 1998, certifikatë për kryerjen me sukses të specializimit lidhur me "Metodat Efektive të Procesit të të Mësuarit, Programi të USAID-it Memphis Tennes".
 - Janar-Mars 2015, specializohet për të Drejtën e Njeriut në Universitetin e Trentos, Itali.
 - 11.01.1993-10.05.1993, "Senior Researcher", Virginia Shcool of Laë, SHBA.
 - Korrik-Gusht 1993, specializohet për të "Drejtën e Krahasuar" në Universitetin e Trentos, Itali.
 - Dhjetor 1991-28.02.1992, specializimi pranë Fakulteit të Ekonomisë, Universiteti Kozencës, Itali.
 - Qershor 2008, specializimi për të "Drejtën Tregtare në Bashkimin Evropian", CEELI Institut.
 - 2002-2005, specializimi në kuadër të një projekti Reform International në Bashkëpunim me Osgood University, Toronto, Kanada.
 - Mars 2003, Trajnim Trajnerësh nga Justice Reform International.
 - Nëntor 1994, specializimi për të Drejtën e Njeriut në Firence, Itali.
 - Gusht-Shtator 1992, specializim pranë Universitetit të Varshavës dhe Universitetit tLodz, Poloni, për të Drejtën e Njeriut dhe Pronësinë Intelektuale.
 - Certifikatë arritje nga Leadership Institute "In recognition of contribution in the Leadership Institute", USA Maj 1998
 - Certifikatë nga programi "Human rights education for legal professions" i Këshillit të Evropës (trajnim trajnerësh me datë 20 Dhjetor 2016)
 - Certifikatë pjesëmarrjeje Këshilli i Evropës dhe Shkolla e Magjistraturës 19 Dhjetor – 21 Dhjetor 2016
 - Certifikatë për kursin "Të drejtat e njeriut dhe minoritetet", datë 11-20 prill 2018
 - Certifikatë nga Academia Evropiane e ligjit EAST-ËEST forum për kursin Integrimi Evropian, Mbrojtja e të drejtave të Njeriut 5-16 Dhjetor 1994
 - Certifikatë pjesëmarrjeje nga Qendra Kombëtare Amerikane - the National center for state courts. Program për liderhipin, për menaxhimin e gjykatave, performancën, 10 Prill 2015
 - Certifikatë për kursin "Trajnim për qarkun e paqes" 26-31 Maj 2008, Shërbimi Novergjez i Ndërmjetësimit
 - Certifikatë për ndjekjen e programit për Menaxhimin e konflikteve dhe Ndërmjetësimit datë 19-28 Maj 2004
 - Certifikatë NGA UN ËOMEN për aftësitë e të folurit në publik 12 Prill 2013
 - Certifikatë pjesëmarrjeje në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore "100 Years Justice and Doctrine" 09 Maj 2013 (së bashku me programin)
 - Certifikatë pjesëmarrjeje në seminarin Vlerësim i Jashtëm i Instutcioneve Akasemike të Nivelit të Lartë

- Certifikatë trajnimi për të rifreskuar aftësitë dhe cilësitë e ndërmjetësve nga IFC, datë 26-27 Shtator 2006
- Certifikatë trajnimi për të rifreskuar aftësitë dhe cilësitë e ndërmjetësve nga IFC, datë 11 Janar 2007
- Certifikatë pjesëmarrjeje për “Zhvillimet Akademike për negociatat”, datë 02- 03 Qershor 2008
- Certifikatë për kryerjen me sukses të trajnimit Për prokurorët në qendrën e trajnimit në Xhankart Indonesi, organizuar nga Department of Justice USA (DoJ), datë 16-18 Mars 2011”
- Certifikatë pjesëmarrje nga International Monetary Found, për të drejtën Bankare, 17-21 Nëntor 2008
- Certifikatë pjesëmarrje në Programin e Bashkëpunimit Shkolla e Magjistraturës Shqiptare me shkollën Homologe Turke për trajnimin në sistemin gjyqësor, datë 07 - 12 Mars 2016
- Certifikatë për kryerjen e programit të trajnimit të trajnerëve, kursi bazik për arbitrazhin dhe ndërmjetësimin tregtar, datë 05 Mars 2003, nga GOËLING Constulting
- Certifikatë datë 30 Tetor 2002 për kryerjen e programit 10 ditor për zgjidhjen Alternative të Konfliktëve, nga GOËLING Constulting.
- Humsec Journal issue 3 Restorative justice and victim-offender mediation in criminal matters (Botim Shkencor).
- Pjesëmarrje në konferencën Ndërkombëtare “Të drejtat Universale: RASTI I KOSOVËS”.
- Letër rekomandimi nga Universiteti i Oslos për kontribute Shkencore, referime dhe botime pranë këtij Universiteti, të lidhura më të drejtat e njeriut dhe Drejtësinë Restauruese datë 25.03.2008.
- Udhëzues për hetimin e Korrupsionit dhe Krimin Financiar referim në aktivitetin Promovues, OPDAT dhe DoJ, SHBA, datë 28 Tetor 2010.
- Referim Steriotipet Gjinore në Shkencë –Seminar Ndërkombëtar Rajonal.
- Referim në Konferencën e 12 Ndërkombëtare të Chief Justice of the Ëorld.
- Certifikatë mirënjohje nga Konferenca e 12 Ndërkombëtare të Chief Justice of the Ëorld.
- Referim për zgjidhjen e konflikteve në konferencën “Demokracia në Edukim”, organizuar nga Këshilli i Evropës.
- Certifikatë mirënjohjeje për Organizimin e Konferencës së tretë Ndërkombëtare për kërkuesit e rinj Shkencor, datë 18 – 19 Prill 2014.
- Certifikatë mirënjohje nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës “In acknowledgement of Outstanding contributions, professional commitment and leadership on behalf of Albania” 08 March 2002.
- Letër mirënjohje nga Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve për referimin në samitin e Stambollit “Ëoman’s prespectives of UN – Post-2015 Development”, datë 31 Maj – 1 Qershor 2014.

25. Sa më sipër, mbështetur në të dhënat e jetëshkrimit të kandidatit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës, si dhe duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trajnuese të ndjekura nga kandidatja Marjana Semini Tutulani, për këtë kriter ligjor vlerësimi Këshilli çmoi ta vlerësojë me **1,66 (një presje gjashtëdhjetë e gjashtë) pikë**.

Njohja e gjuhëve të huaja

26. Në shkronjën “c” të pikës 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi niveli i zotërimit të gjuhëve të huaja.
27. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin dhe numrin e gjuhëve të huaja, si edhe nivelin e zotërimit të tyre nga ana e kandidatëve, duke pasur parasysh sasinë e pikëve maksimale përkatëse sipas vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.
28. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati ka vetëdeklaruar në jetëshkrim se njih shumë mirë gjuhën “Angleze” dhe gjuhën “Italiante” dhe si dokument për të provuar njohjen e këtyre gjuhëve të huaja, ka paraqitur:
- Për gjuhën “Angleze” – dëshmi nr. 3399, datë 19.12.1989 vlerësuar me notën 8, pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës;
- Për gjuhën “Italiante”- dëshmi me provim pasuniversitar datë 03.02.1994, vlerësuar me notën 9, pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës. Në dosje e kandidimit janë administruar dëshmitë përkatëse.
29. Në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Caktimit të Pikëve lidhur me këtë kriter vlerësimi citohet ndër të tjera se, për vlerësimin e njohurive për gjuhët e huaja, në rastet kur Këshilli e vlerëson të nevojshme, do të caktojë ekspertë të gjuhës së huaj, të cilët japin mendim për shkallën e zotërimit të aftësive gjuhësore të kandidatit/es. Shkalla e zotërimit të aftësive gjuhësore të kandidatit/es mund të vlerësohet deri në 3 Pikë. Gjithashtu, Këshilli mban parasysh edhe zotërimin e gjuhëve të tjera të deklaruara për të cilat kandidati/ja nuk testohet gjatë intervistës, me kushtin që të jenë të shoqëruara me dokumente vlerësuese të vlefshme për nivelin e njohurive të tyre. Në këtë rast, krahas vlerësimit konkret me pikë për gjuhën e huaj të zgjedhur prej tij/saj për pikëzim, kandidati/es mund t'i shtohet 1 Pikë.
30. Kandidatja Marjana Semini Tutulani u intervistua në gjuhën e huaj Angleze, pasi në përgjigje të njoftimit të Këshillit të datës 16.11.2022, ka theksuar se: *“Kërkon të vlerësohet në gjuhën “angleze”*. Gjithashtu, gjatë intervistës së zhvilluar me Këshillin në datën 22.11.2022, për verifikimin e shkallës së zotërimit të gjuhës angleze, kandidatja Marjana Semini Tutulani zhvilloi edhe bisedën me ekspertin e zgjedhur nga Këshilli, Etleva Kondi. Në mendimin me shkrim të depozituar pranë Këshillit, ekspertja e njohurive të gjuhës angleze ka ardhur në përfundimin se kandidatja Marjana Semini Tutulani *“njeh dhe zotëron shumë mirë gjuhën angleze”*, duke sugjeruar vlerësimin me **2 (dy) Pikë**.
31. Për këto arsye, duke pasur parasysh mendimin me shkrim të ekspertes së vlerësimit të shkallës së zotërimit të gjuhës angleze me 2, (dy) pikë, si edhe faktin që kandidatja Marjana Semini Tutulani zotëron edhe gjuhën italiane për të cilën zotëron dëshmi të lëshuar nga Universiteti i Tiranës, për të cilën vlerësohet me 1 (një) pikë tjetër,

Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Marjana Semini Tutulani për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **3.33 (tre pikë tridhjetë e tre) pikë**.

B. Meritat profesionale – Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional

32. Në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e përgjithshëm profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.
33. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale prej 30 pikësh, sipas vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të KED, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.
34. Në rastin e kandidates Marjana Semini Tutulani, Këshilli shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e saj profesionale, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të kësaj kandidate në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.
35. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidatja Marjana Semini Tutulani ka dorëzuar punimet profesionale si më poshtë vijon:
- a) Publikime profesionale dhe kërkime shkencore:
- Komentarin e ligjit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, bashkëautore, shtëpia botuese “Gent Grafik”, Dhjetor 2021.
 - Manual “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit dhe Programet e Drejtësisë Restauruese”, bashkëautore, shtëpia botuese “Dëllinja”, Maj 2020.
 - Manual “Hetimi dhe ndjekja e veprave penale që lidhen me pronësinë intelektuale në Shqipëri”, autore, botuar ËIPO dhe DPPI, Gjeneve e Tiranë, 2020.
 - Komentuari i “Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur”, bashkëautore, EURALIUS dhe Shkolla e Magjistraturë, 2018.
 - Detyrimet dhe Kontratat, autore, shtëpia botuese “Scanderbeg Books”, 2016.
 - Konfliktet e punës në gjykata nën këndvështrimin e barazisë gjinore, autore, PNUD dhe Shkolla e Magjistraturës, 2014.

- Manuali “Vademecum- Për Shërbimet e Avokatisë”, bashkëautore, OSBE dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Korrik 2014.
- Manual mbi Ligjin Shqiptar të Falimentimit, bashkëautore, shtëpia botuese “Malkuka”, Korrik 2013.
- Komentari mbi Ligjin Shqiptar për Ndërmjetësimin, bashkëautore, UNICEF, ACR dhe Ministria e Drejtësisë, Nëntor 2012.
- Libri “Mbrojtja e trashëgimisë nënujore në Shqipëri”, bashkëautore, UNESCO dhe ACLTS, shtëpia botuese “M&B”, Dhjetor 2013.
- Monografia “E drejta e autorit në Shqipëri”, autore, shtëpia botuese “Scanderbeg Books”, 2012.
- Fjalori Enciklopedik Shqiptar, bashkëautore, Akademia e Shkencave e RSH, Janar 2011.
- Libri “Statusi Ligjor i të Mituri dhe të Drejtat e tyre”, autore, shtëpia botuese “Print Media”, Maj 2008.
- Teksti për shkollat e mesme “Njohuri për shoqërinë III”, bashkëautore, shtëpia botuese “Plejad”, 2007.
- Manual për mësuesit “Ndërmjetësimi i konfliktet në grupmoshat shkollore”, bashkëautore, UNICEF, 2006.
- Manual për ndërmjetësimin dhe pajtimin në rastet konflikteve nga trafikimi i njerëzve, bashkëautore, USAID, Shkurt 2006.
- Manual për trajnerët e ndërmjetësimin dhe pajtimin në rastet konflikteve nga trafikimi të njerëzve, bashkëautore, USAID, Qershor 2006.
- Cikël leksionesh, E drejta Civile, Subjektet e së Drejtës Civile, autore, shtëpia botuese “Scanderbeg Books”, 2003.
- Pronësia intelektuale, bashkëautore, shtëpia botuese “Kristalina KH”, 2004.
- Rregullat kryesore mbi të drejtën e Biznesit, bashkëautore, shtëpia botuese “Afërdita”, 1999.
- Manual i trajnimit për ndërmjetësim, bashkëautore, shtëpia botuese “OMBRA GVG dhe AFCR”, 1999.
- Libri Adoleshentët të konfliktuar apo..., bashkëautore, shtëpia botuese “Dija”, 1998.
- Teksti “E drejta dhe legjislacioni agrar (150 faqe) shkollën e mesme bujqësore”, bashkëautore, shtëpia botuese e librit shkollor, 1998.
- Teksti “Sociologjia nr. 2, shkollat e mesme”, bashkëautore, shtëpia botuese e librit shkollor, 1995.
- Monografia “Kontrata e shitblerjes në ekonominë e tregut”, autore, shtëpia botuese e librit Universitar, 1995.
- Përkthim në Shqip, “E drejta e krahasuar, Parimet e Përgjithshme”, autore, shtëpia botuese “Scanderbeg Books”, 1995 dhe 2012.
- Teksti “E drejta dhe legjislacioni”, autore, shtëpia botuese e librit shkollor, 1994.
- Cikël leksionesh “E drejta Tregtare”, bashkëautore, shtëpia botuese e librit Universitar, 1994.
- Libri “International Intellectual Property, vol 2”, kontribuese, shtëpia botuese “Prentice Hall Laë & Business”, 1992.

b) **Artikuj shkencore:**

- 1- Artikulli shkencor me titull: “Forca madhore si shkak i pamundësisë së përmbushjes së detyrimeve kontraktore. Aktet ndërkombëtare në lidhje me forcën madhore dhe

- trajtimi i forcës madhore në jurisprudencën e GJED-së,— botuar në Revistën shkencore “Jeta Juridike” Nr. 1/ 2021.
- 2- Autore e artikullit shkencor “E drejta për t’u harruar - Balanca midis mbrojtjes së të dhënave personale dhe lirisë së shprehjes. Legjislacioni dhe jurisprudenca e GJED, GJEDNJ dhe shqiptare”, në revistën shkencore “Jeta Juridike” No. 1/2018.
 - 3- Artikulli “Të drejtat e njeriut në kurrikulat e trajnimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës” në anglisht botuar në librin “Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe rasti i Kosovës” nga Universiteti i Bergamos Itali, Universiteti i Rijekes, Universiteti i Prishtinës dhe Qendra e Kërkimeve për të Drejtat e Njeriut dhe Integrimi Evropian.
 - 4- Autore e artikullit shkencor: “Media sociale dhe kufijtë e lirisë së shprehjes. Mbrojtja e jetës private dhe familjare dhe mbrojtja e dinjitetit dhe e personalitetit në perspektivën e jurisprudencës shqiptare dhe të GJEDNJ- së. Botuar në Tiranë, në revistën juridike shkencore “Jeta Juridike” Nr. 3/2016.
 - 5- Artikulli “Restorative Justice and Victim-Offender Mediation in Criminal Matters dealing ëith Teenagers and Youngsters in Albania”, bashkëautore kryesore, së bashku me L.Mandia botuar në revistën shkencore HUMSEC.
 - 6- Referim “E drejta e jetës private dhe dëmi jashtëkontraktor në rastet e shkeljeve” mbajtur në seminarin ndërkombëtar shkencor “për një të drejtë në limitet e një njeriut” organizuar nga Universiteti i Barit Itali, CEDICLO, Universiteti Evropian dhe Fakulteti i Drejtësisë “Justicia” në Tiranë, 17 Prill 2009.
 - 7- Autore e artikullit “Autorësia dhe çështjet e pronësisë në të drejtat e autorit me punët artistike të ndodhura në vende publike”, botuar në revistën shkencore “Avokatia Literum”, Nr. 2,2012.
 - 8- Autore e artikullit “Dëmi jashtëkontraktor dhe shpërblimi i dëmit në praktikën gjyqësore” botuar në revistën shkencore “Jeta Juridike” Nr. 1, 2012.
 - 9- Autore e artikullit “E ka mbushur djalli. Armët dhe rreziku i tyre në situatat e dhunës në familje.” Botuar në revistën “Ligji mundësi zhvillimi për gratë”. Botim i QAG. Nr. 1 (18), mars 2008. (faqe 7-16).
 - 10- Artikulli “Pronësia në çështjet e të drejtës së autorit dhe mënyrat e transferimit të pronësisë” botuar në revistën “Justitia”, Nr. 1/2008.
 - 11- Artikulli “çështjet gjyqësore për kontratën e shitjes, lëvrimi i mallrave dhe sipërmarrja” botuar në revistën “Studime Juridike” Nr. 2/2007.
 - 12- Artikulli “Të drejtat e njeriut në kurrikulat e trajnimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës” në anglisht botuar në librin “Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe rasti i Kosovës” nga Universiteti i Bergamos Itali, Universiteti i Rijekes, Universiteti i Prishtinës dhe Qendra e Kërkimeve për të Drejtat e Njeriut dhe Integrimi Evropian.
 - 13- Artikulli “Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve me Ndërmjetësim në Evropë” botuar në anglisht me ISBN nga Qendra Evropiane dhe Ballkanike, Universiteti i Bolonjës dhe Polo Scientifico-Didattico, Forli, Itali për botimin në librin “Pravda na tlu Evrope - Zakonski principi u presirenoj Evropi” botuar nga Centro per l’Europa Orientale dhe Balcanica, Sarajevo 2006, me ISBN 9958-635-45-3.
 - 14- Artikulli “Disa përjashtime nga mbrojtja e të drejtave të autorit”, botuar në revistën Jeta Juridike nr. 2, Dhjetor 2007.
 - 15- Artikulli “Koncepti i drejtësisë restauruese” botuar në revistën “ndërmjetësimi” Nr. 1/26/2007.
 - 16- Artikull “Paditë që lidhen me kontratat tregtare” botuar në revistën shkencore “Tribuna Juridike, Nr. 2/2007;

- 17- Artikulli "Dëmshtëpërblimi i dëmeve dhe e drejta e autorit" botuar në revistën "e drejta parlamentare dhe politikat ligjore", Nr. 23/2005.
- 18- Artikulli "Zgjidhja e kontratës dhe revokimi i saj." botuar në revistën shkencore "Tribuna Juridike, Nr. 1/2005;
- 19- Artikulli "Disa mendime teorike dhe praktike lidhur me anulimin ose tërheqjen e kontratës", botuar në revistën "Studime Juridike" Nr. 1/2005.
- 20- Artikulli me temë "Demi jopasuror nën rregullimin juridik të Kodit Civil" botuar në revistën Jeta Juridike Nr. 1, gusht 2003.
- 21- Artikulli "Demi jopasuror nën rregullimin juridik të Kodit Civil" botuar në revistën shkencore "Jeta Juridike", Nr. 1/2003.
- 22- Artikulli me temë "Personat juridike privatë. Vështrim krahasues" botuar në revistën Jeta Juridike Nr. 1. Qershor 2002.
- 23- Artikulli "Disa mendime mbi kontratat dhe interpretimi i tyre në Kodin e ri Civil shqiptar" - botuar në revistën Drejtësia Nr. 3/1995.
- 24- Artikulli "Legjislacioni i ri për kontratën e qirasë", botuar në revistën Albanian Observer Nr. 3/1995.
- 25- Artikulli "Periudhat e parashkrimit në legjislacionin civil shqiptar", botuar në revistën Albanian Observer Nr. 4/1995.
- 26- Artikulli "Bankat si subjekte të rëndësishme juridike në ekonominë e tregut dhe statusi i tyre ligjor", botuar në revistën Albanian Observer Nr. 5/1995.
- 27- Artikulli "Shitja e tokës" botuar në revistën Albanian Observer Nr. 10/1995.
- 28- Artikulli "Disa mendime për shitjet në Kodin e ri Civil Shqiptar" revista "Drejtësia" Nr. 2/1992.
- 36.** Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Këshilli vlerëson se *në aspektin sasior* kandidatja Marjana Semini Tutulani ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë mbi atë që mund të gjykohet si një angazhim i zakonshëm apo "mesatar" në ushtrimin e profesionit.
Pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë dorëzuar vlerësimet të realizuara nga punëdhënësit për kandidaten, si dhe institucioni përkatës (Shkolla e Magjistraturës) bënë me dije se:
"Prof.Dr.Mariana Semini,pedagoge e brendshme e Shkollës së Magjistraturës për vitet akademike 2017-2018 dhe 2021-2022 vlerësohet me 300 pikë me vlerësimin "Shumë mirë" dhe për shkak të ngarkesës mësimore të realizuar në masën 192% ose mbingarkesës mësimore të përballuar në programin e trajnimit fillestar 92% dhe në programin e trajnimit vazhdues ka realizuar ngarkesën 225% ose mbingarkesën në masën 125%.Pedagoge Marjana Semini Tutulani vlerësohet në total me 340 pikë me vlerësimin "Shkëlqyeshëm". Për këto arsye, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Marjana Semini Tutulani për këtë kriter ligjor vlerësimi me **4,77 (katër presje shtatëdhjetë e shtatë) Pikë.**
- 37.** Për sa i përket *vlerësimit cilësor*, Këshilli shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja Marjana Semini Tutulani, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej saj, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionalë dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit

dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin Kushtetuta dhe ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Këshill dhe, më tej, për përzgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nga organet e emërtesës.

38. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, kandidatja Marjana Semini Tutulani ka depozituar pranë Këshillin dokumentacionin përkatës për vlerësim, në zbatim të njoftimit të Këshillit në datën 18.11.2022, kandidatja Marjana Semini Tutulani, ka përcaktuar për vlerësim pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi 5 (pesë) dokumente specifik si vijon:
- a) *Artikullin shkencor me titull: "E drejta për t'u harruar" dhe balanca midis mbrojtjes së të dhënave private dhe lirisë së shprehjes. Legjislacion dhe jurisprudencë nga GJED-ja, GJEDNJ-ja dhe ajo shqiptare" — botuar në Revistën shkencore "Jeta Juridike" Nr. 1/2018.*
 - b) *Artikullin shkencor me titull: "Media sociale online dhe kufijtë e lirisë së shprehjes. Respektimi i të drejtave për jetën private dhe familjare dhe mos cenimi i emrit dhe dinjitetit", — botuar në Revistën shkencore "Jeta Juridike" Nr. 4/2015.*
 - c) *Artikullin shkencor me titull: "Forca madhore si shkak i pamundësisë së përmbushjes së detyrimeve kontraktore. Aktet ndërkombëtare në lidhje me forcën madhore dhe trajtimi i forcës madhore në jurisprudencën e GJED-së, — botuar në Revistën shkencore "Jeta Juridike" Nr. 1/2021.*
 - ç) *Monografia: "Konfliktet e punës në gjykata nën këndvështrimin e barazisë gjinore" të përgatitur në kuadrin e një Projekti të PNUD me Shkollën e Magjistraturës. Publikuar në Tiranë, Maj 2014.*
 - d) *Tekstin Universitar "E Drejta e detyrimeve dhe e kontratave", Shtëpia Botuese "Scanderbeg Books".*
 - e) *vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit lidhur me çështjen 2016/1.*
 - ë) *Vendimin e Bordit disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë nr. 2/2021.*
39. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidatja Marjana Semini Tutulani, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi. Këshilli shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë edhe ato të përmendura në Shtojcën nr. 1 të vendimit sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.
40. Dokumentet profesionale të shqyrtuara trajtojnë tematika të ndryshme që lidhen me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si e drejta për jetën private dhe atë familjare, liria e shprehjes, si dhe tematika të të drejtës private si konfliktet e punës, e drejta e detyrimeve dhe kontratave, parë këto dhe në aspektin e të drejtës ndërkombëtare.
41. Njëri ndër indikatorët vlerësues të dokumenteve profesionalë është *"Originaliteti dhe/ose impakti"*, duke marrë në konsideratë faktin se nuk ka të dhëna për plagjiaturë të dokumentit. Nisur nga profili profesional dhe angazhimi shkencor i kandidates Marjana Semini Tutulani, përmbajtja e dokumenteve të përzgjedhura, dobisë së përdorimit të tyre nga profesionistë të fushës por edhe nga grupe interesi dhe publiku i

gjerë, Këshilli vëren se publikimet dhe artikujt e analizuar dëshmojnë qasje profesionale origjinale veçanërisht mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, çështje për të cilat ka një nevojë të veçantë për njohje dhe zbatim.

42. Këshilli, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin "*Originaliteti dhe/ose impakti*", duke marrë në konsideratë faktin se nuk ka të dhëna për plagjiaturë të dokumentit, vjen në përfundimin se lidhur me këtë tregues vlerësimi kandidatja Marjana Semini Tutulani vlerësohet me **5,77 (pesë presje shtatëdhjetë e shtatë) pikë**.
43. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me "*Aftësitë analitike*", Këshilli vëren se posaçërisht pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, sikurse edhe në rastin e publikimeve dhe artikujve profesionalë, kandidatja Marjana Semini Tutulani tregon zotërimin e aftësive të larta për të analizuar informacionin dhe për të identifikuar, arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore, parimet dhe institutet e së drejtës, sipas natyrës dhe qëllimit të vetë këtyre punimeve.
44. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin "*Aftësitë analitike*", Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Marjana Semini Tutulani vlerësohet me **5,88 (pesë presje tetëdhjetë e tetë) Pikë**.
45. Në lidhje me treguesin vlerësues "*Aftësitë kërkimore*", Këshilli shqyrtoi dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Marjana Semini Tutulani, sikurse edhe publikimet dhe artikujt profesionalë, të paraqitur në dosjen e kandidates. Nga ky shqyrtim, Këshilli vëren se këto punime përmbajnë informacione të lidhura me fusha të larmishme të së drejtës, kryesisht me të drejtat e njeriut. Për arritjen e lëndës së trajtuar dhe qëllimin e trajtimit shkencor, nga përmbajtja e secilit prej punimeve të shqyrtuara, adresohen analiza krahasimore duke përdorur burime të ndryshme të doktrinës dhe praktikës gjyqësore, vendase dhe ndërkombëtare.
46. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin "*Aftësitë kërkimore*", Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Marjana Semini Tutulani vlerësohet me **4 (katër) pikë**.
47. Për treguesit "*Saktësia dhe precizoni*", në thelb, u verifikua nëse në veprimtarinë profesionale të kandidates janë mbuluar me profesionalizëm tematika e përzgjedhur dhe materiali ka shmangur përsëritjet apo citimet e panevojshme etj. Nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Marjana Semini Tutulani, Këshilli vëren se këto punime tregojnë nivel të lartë të parashtrimit të problemeve juridike për analizë dhe zgjidhje, përdorim korrekt të terminologjisë juridike dhe të gjetjeve nga legjislacioni, doktrina, si edhe praktika gjyqësore.
48. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin "*Saktësia dhe precizoni*", Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Marjana Semini Tutulani vlerësohet me **3,88 (tre presje tetëdhjetë e tetë) Pikë**.

49. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Qartësia*”, Këshilli shqyrtoi dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Marjana Semini Tutulani, sikurse edhe publikimet dhe artikujt profesionalë të paraqitur në dosjen e kandidates. Këshilli vëren se këto punime janë të organizuara dhe strukturuara në mënyrën e duhur, gjuha e përdorur është e pasur dhe profesionale. Qartësia e gjuhës së përdorur dhe strukturimi i materialit i bëjnë këto punime të kuptueshme dhe të lexueshme, sipas natyrës së punimit dhe grupeve të interesit të cilave synon ti drejtohet.
50. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Qartësia*”, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Marjana Semini Tutulani vlerësohet me **3,88 (tre presje tetëdhjetë e tetë) Pikë**.
51. Këshilli, pasi shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja Marjana Semini Tutulani, për sa i përket vlerësimit cilësor, vjen në përfundimin se kandidatja Marjana Semini Tutulani vlerësohet në total me **24,22 (njëzet e katër presje njëzet e dy) Pikë**.

C. Meritat profesionale – Kualifikimi Shtesë Profesional

52. Në shkronjën “b” të pikës 2 dhe shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e shtesë profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi që kandidatët të kenë veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe në sfera të tjera të së drejtës, vlerësim të dallueshëm të rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, përvojë të veçantë në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë, si edhe pjesëmarrje të dallueshme në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislationit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës.
53. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 12 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 8 pikë ekspertizën në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizën në fusha të tjera të veçanta të së drejtës. Gjithashtu, Këshilli vlerëson deri në 4 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

Specializimi në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës

54. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizës në fusha të tjera të veçanta të së drejtës*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe

dokumente të tjera zyrtare mbi rezultate të vlerësimit profesional etj., si edhe nga shqyrtimi i dokumentet profesionale të paraqitura nga kandidatja Marjana Semini Tutulani, Këshillit i rezulton se karriera profesionale e kësaj kandidate është fokusuar në pjesën dërmuese të kohëzgjatjes dhe shtrirjes në fushën e të drejtës private dhe te drejtave dhe lirive themelore te njeriut, si profesor dhe lektor i të drejtës, si dhe ekspert ligjor dhe koordinator në disa projekte, kombëtare dhe ndërkombëtare.

55. Këshilli vëren se në formimin profesional, specializimin dhe ekspertizën e posaçme profesionale të fituar nga kandidatja Marjana Semini Tutulani, një rol të veçantë ka edhe interesi i treguar vetjak profesional për ushtrimin e vazhdueshëm të veprimtarive profesionale si Përgjegjëse e Trajnimit Fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shkollën e Magjistraturës, Eksperte e Lartë e Komisionit të Reformës Ligjore në nënkomisionet që lidhen me edukimin ligjor, drejtësinë penale për të mitur dhe profesionet e lira, Eksperte për Projektin e USAID në trajnimin e vazhdueshëm të avokatëve dhe asistent avokatëve, Eksperte e JUST/USAID për përgatitjen e Planveprimit për konsolidimin dhe forcimin e Shkollës Kombëtare të Avokatisë, Eksperte e UNESCO-s dhe ACTL-së në një studim mbi legjislacionin për trashëgiminë nënujore dhe trafikimin e objekteve arkeologjike, Anëtare e Komisionit të Dytë për Reformën Ligjore, krijuar nga Kryeministri për përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE.

Nga ana tjetër, edhe studimet pasuniversitare të ndjekura, kanë ndikuar në formimin profesional dhe specializimin e kësaj kandidate në fushën e të drejtës private, dhe të të drejtave të njeriut. Rezulton e provuar se kandidatja ka ndjekur specializimet:

-Korrik-Gusht 1993, specializohet për të drejtën e krahasuar në programin TEMPUS, në Universiteti i Trentos, Itali;

-Janar-Maj 1993, për zgjidhet dhe fiton Fullbright Scholarship për Senior Reseracher në Fakultetin e Drejtësisë në Virginia, USA për një kërkim shkencor në fushën e shitjes së mallrave dhe të drejtat e konsumatorit nënprespektive kushtetuese.

-Nëntor 1994, pjesëmarrëse në kurs specializimi tre javor mbi Të drejtat e Njeriut në Firenze, Itali nga Akademia e të Drejtës Evropiane.

-Janar-Mars 1995, specializohet për të drejtat e njeriut në Universitetin e Trentos Itali mbështetur në një Program të Komitetit të Venecias.

56. Së fundi, si rrjedhojë dhe reflektim i përgatitjes profesionale dhe përvojës së fituar, kandidatja Marjana Semini Tutulani në cilësinë e autorit ka realizuar punime profesionale dhe artikuj shkencorë, të cilat në pjesën më të madhe të tyre, trajtojnë aspekte të ndryshme të së drejtës, ndër të cilat ka edhe aspekte që lidhen me njohjen, respektimin dhe mbrojtjen e lirive themelore e të drejtave të njeriut.

57. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës*” Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidates Marjana Semini Tutulani **7,22 (shtatë presje njëzet e dy) pikë.**

Angazhime profesionale shtesë

58. Nga vetëdeklarimet e kandidates Marjana Semini Tutulani, të mbështetura në dokumentacionin përkatës të depozituar prej saj pranë KED, rezulton se ka pasur këto angazhime shtesë profesionale:

- *Qershor 2009-Korrik 2013, Drejtore e Shkollës së Magjistraturës.*

- Tetor 2006-Qershor 2009, Përgjegjëse e Trajnimit Fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shkollën e Magjistraturës.
- Shtator 1988-Shtator 1997, emërohet pedagoge e brendshme për “Kontratat dhe detyrimet” në Fakultetin e Drejtësisë të UT.
- Eksperte e ILO-s (International Labour Organization) në trajnimin për zgjidhjen e konflikteve me ndërmjetësim dhe pajtim në sektorin privat dhe për draftimin e akteve nënligjore dhe trajnimin e profesionistëve mbi ndërmjetësimin në marrëdhëniet e punës dhe në konfliktet kolektive. (Janar 2021-2023)
- Eksperte e UNDP në projektin mbi Dhunën në Familje, dhunën me bazë gjinore. Projekti është i orientuar në draftim legjislativ përgatitje manualesh, komentari dhe trajnime të gjyqtarëve dhe prokurorëve, policisë së shtetit dhe administratës publike. (Janar 2020-Shtator 2022)
- Eksperte e WIPO në Projektin WIPOlex për përgatitjen e të dhënave të vendimeve gjyqësore që lidhen me pronësinë intelektuale dhe krijimin e databases së Shkollës së Magjistraturës për këtë. (Mars-Dhjetor 2022)
- Eksperte e PNUD-it në projektin për mbrojtjen nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual në forcat e armatosura në Republikën e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe në universitetet publike. Draftimi I Dokumentit të politikave. (Shtator 2020-Korrik, 2022)
- Eksperte e Terre des Hommes, Hungary për përgatitjen e Raportit Kombëtar për Shqipërinë mbi Drejtësinë Restauruese dhe ndërmjetësimin në rastet ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin. (Janar- Qershor 2021)
- Eksperte e Terre des Hommes në Projektin I-Restore Protecting Child Victims Through Restorative Justice, Justice Program of the European Union Justice. (Janar 2020-Dhjetor 2021)
- Eksperte e UNDP në Projektin “Leave no one behind” për draftimin e 36 akteve nënligjore të ligjit për banesat sociale 22/2018. (Shtator 2018-2020)
- Eksperte e OSBE për Trainimin e Trainerëve (ToT) në Shkollën e Magjistraturës për mësimin në distancë dhe ngritjen e kapaciteteve në kushtet e pandemisë. (Nëntor 2019)
- 2015-2016, Eksperte e Lartë e Komisionit të Reformës Ligjore në nënkomisionet që lidhen me edukimin ligjor, drejtësinë penale për të mitur dhe profesionet e lira.
- Qershor 2015-Korrik 2016, Eksperte për Projektin e USAID në trajnimin e vazhdueshëm të avokatëve dhe asistent avokatëve në Dhomat Lokale Fier, Vlorë, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Durrës me përkrahje të CHEMONICS (Viti III).
- Shkurt 2013-Korrik 2012, Eksperte për Projektin e USAID në trajnimin e vazhdueshëm të avokatëve dhe asistent avokatëve në Dhomat Lokale Fier, Vlorë dhe Durrës me përkrahje të CHEMONICS (Viti II).
- Qershor 2011-Korrik 2012, Eksperte për Projektin e USAID në trajnimin e vazhdueshëm të avokatëve dhe asistent avokatëve në Dhomat Lokale Vlorë dhe Durrës me përkrahje të CHEMONICS (Viti I).
- Korrik -14 korrik 2015, Eksperte e IFC për trajnimin e gjyqtarëve për falimentin dhe për përgatitjen e manualeve, kurrikulave dhe materialeve për botim.
- Qershor –Tetor 2014, Eksperte për përgatitjen e Projektligji për bilbilfryrësit në bashkëpunim me një ekip ndërkombëtar nga Universiteti Utrecht-it.
- Prill-Korrik 2013, Trajnere dhe eksperte në përgatitjen Manualit për falimentin në Shqipëri të botuar në Korrik 2013 dhe për organizimin e seminareve me gjyqtarët në mbarë Shqipërinë.

- 1-30 Dhjetor 2013, Eksperte e JUST/USAID për përgatitjen e Planveprimi për konsolidimin dhe forcimin e Shkollës Kombëtare të Avokatisë.
- Korrik-Dhjetor 2013, Eksperte e UNESCO-s dhe ACTL-së në një studim mbi legjislacionin për trashëgiminë nënujore dhe trafikimin e objekteve arkeologjike, botuar në Dhjetor 2013.
- 2012-2013, Eksperte në Projektin e Berzhit dhe Shkollën e Magjistraturës për organizimin e seminareve për çështjet tregtare dhe përgatitjen e materialeve përkatëse.
- 2006-2009, Anëtare e Komisionit të Dytë për Reformën Ligjore, krijuar nga Kryeministri për përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE dhe nënkryetare e tij nga viti 2007-2009.
- 2004- 2006, Anëtare e Komisionit të Dytë për Reformën Ligjore, krijuar nga Kryeministri për përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE.
- Shtator 2005-2006, Eksperte e Casala ane Associates, Tiranë një projekt të pronësisë intelektuale duke dhënë kontribut në disa projekte si një trajnere në seminare me gjyqtare dhe prokurë të organizuar me Shkollën e Magjistraturës.
- 2000-2005, Eksperte e Bankës Botërore në një projekt me Justice Reform Interantional në bashkëpunim me Osgood University, Toronto Canada për përgatitjen dhe publikimin e gjashtë teksteve në fusha të ndryshme të së drejtës.
- Prill-Dhjetor 2004, Eksperte për përgatitjen e Manualit të Ligjit të falimentimit shqiptar.
- Prill 2004-2006, Eksperte e ECO në përgatitjen e Analizës Gap Institucionel në Ministrinë e linqës etj.

59. Nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumentet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidimit, rezulton se kandidatja Marjana Semini Tutulani, krahas periudhës të përlloritur si vjetërsi në profesion, ka ushtruar edhe veprimtari profesionale shtesë siç rezulton e cituar më sipër. Këto angazhime shtesë profesionale janë të lidhura me kontribute dhe pjesëmarrje në përgatitjen e analizave ligjore dhe studimeve mbi çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut, pronësisë intelektuale, konflikteve të punës, e drejta e kontratave, e drejta e autorit, barazisë gjinore etj.
60. Prandaj, duke pasur parasysh këto angazhime shtesë profesionale, të shtrira në kohë dhe me kontribute konkrete profesionale në disa nga fushat më të rëndësishme të së drejtës, Këshilli vlerëson që për kriterin vlerësues të “angazhimeve profesionale shtesë”, t’i caktojë kandidatës Marjana Semini Tutulani **3,11 (tre presje njëmbëdhjetë) pikë**.

Meritat Morale

61. Në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për “integritetin etik e moral”. Po kështu, në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 përcaktohen si kriter “Rezultatet e vlerësimit të etikës së kandidatëve gjatë punës, nëse ka”, ndërsa në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni përcaktohen si kriter vlerësimi edhe “Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve” dhe “cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë

përsipër përgjegjësi”. Së fundi, në shkronjën “c” parashikohet si kriter vlerësimi edhe “angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kritereve.

62. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 30 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 18 pikë *integritetin etik dhe moral*, deri në 10 pikë *reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve* dhe deri në 2 pikë *angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.
63. Në lidhje me “meritat morale”, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, mbahen parasysh edhe gjetjet në procedurën e verifikimit të kandidatit, ku përmbahen të dhëna që kanë të bëjnë apo mund të përdoren për efekte të vlerësimit të integritetit etik e moral të kandidatit, angazhime në kauza të shoqërisë civile etj. Gjithashtu, për këtë komponent të vlerësimit mbahen parasysh edhe të dhëna e përfundime që mund të nxirren gjatë intervistës së kandidatit me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.
64. Nga kandidati në lidhje me këtë kriter janë dorëzuar dokumente që kanë të bëjnë me vlerësime të marra nga institucionet pranë të cilës kandidatja ka ushtruar veprimtarinë profesionale, ku vlerësimi i saj për vitet 2017-2018 dhe 2021-2022 nga Shkolla e Magjistraturës është “Shkëlqyeshëm”.
65. Në rastin e kandidates Marjana Semini Tutulani, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të kësaj kandidatje.

Integriteti etik e moral

66. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *integritetit etik e moral*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidates me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga të dhëna të tjera të cilat rezultojnë nga dokumentacioni i paraqitur si:
Letër rekomandimi nga Universiteti i Oslos për kontribute shkencore, referime dhe botime pranë këtij Universiteti, të lidhura më të drejtat e njeriut dhe Drejtësinë Restauruese datë 25.03.2008;

Certifikatë mirënjohje nga Konferenca e 12 Ndërkombëtare të Chief Justice of the World; Certifikatë mirënjohjeje për Organizimin e Konferencës së tretë Ndërkombëtare për kërkuesit e rinj Shkencor, datë 18 – 19 Prill 2014;

Certifikatë mirënjohje nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës “In acknowledgement of Outstanding contributions, professional commitment and leadership on behalf of Albania” 08 March 2002;

Letër mirënjohje nga Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve për referimin në samitin e Stambollit “Woman’s perspectives of UN – Post-2015 Development”, datë 31 Maj – 1 Qershor 2014;

Këshillit i rezulton se kandidatja Marjana Semini Tutulani në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e saj tregon angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje për t’iu përgjigjur me kujdesin e duhur pyetjeve, të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.

67. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*integritetit etik e moral*” Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidates Marjana Semini Tutulani **17,55 (shtatëmbëdhjetë presje pesëdhjetë e pesë) pikë.**

Reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve

68. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se kandidatja Marjana Semini Tutulani në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e saj nuk heziton të tregojë angazhim në përmbushjen e detyrave të saj. Sipas të dhënave që disponohen Këshillit i rezulton se kandidatja Marjana Semini Tutulani reflekton përgjegjshmëri në angazhimet e saj profesionale.

69. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*” Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidates Marjana Semini Tutulani **10 (dhjetë) pikë.**

Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile

70. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se, kandidatja Marjana Semini Tutulani ka qenë i angazhuar në veprimtari të tjera profesionale, në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile si barazia gjinore, ndërmjetësimi në zgjidhjen e mosmarreveshjeve, pjesëmarrja në mësimdhënie dhe edukimin e brezave të rinj.

71. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*” Këshilli vlerëson kandidaten Marjana Semini Tutulani me **1,22 (një presje njëzet e dy) pikë.**

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

72. Në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016 parashikohen si kritere vlerësimi disa komponentë të lidhura me aftësitë profesionale dhe personale të kandidatëve mbi çështjet e natyrës drejtuese, organizative, të kapacitetit për vendimmarrje, punës në grup, të komunikimit dhe përfaqësimit publik. Kështu, në pikën 3 të këtij neni parashikohen kriteret vlerësuese për kandidatët si më poshtë:
- “a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin”;
 - b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
 - c) aftësitë e komunikimit;
 - ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
 - d) aftësitë e përfaqësimit publik.”
73. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kritereve.
74. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 10 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 3 pikë *cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin* kandidatët, deri në 4 pikë *aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*, deri në 2 pikë *aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*, si edhe me 1 pikë për *aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.
75. Në rastin e kandidatës Marjana Semini Tutulani, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale të kësaj candidate.

Cilësia e platformës dhe të vizionit

76. Këshilli shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës mbi motivimin e kandidimit dhe vizionit të kandidatës Marjana Semini Tutulani lidhur me qasjen dhe qëndrimet e saj mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së

gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, mbi sfidat kryesore me të cilat është përballur dhe duhet të përballlet Gjykata Kushtetuese në ushtrimin e përgjegjësve dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Këshilli mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga kjo kandidatë gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Këshillit.

77. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Këshilli vëren se kandidatja Marjana Semini Tutulani ka njohuritë mbi rëndësinë e misionit, kërkesave etike morale dhe profesionale që dikton pozicioni i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese si edhe të kësaj Gjykate, në respektimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe në tërësi të mirëfunksionimit të sistemit demokratik dhe shtetit ligjor. Gjithashtu, kjo kandidatë parashtrori aftësitë dhe përkushtimin e saj për përmbushjen e misionit të Gjykatës Kushtetuese.
78. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues *“cilësia e platformës dhe të vizionit të paraqitur”* Këshilli vlerësoi t'i caktojë kandidatës Marjana Semini Tutulani **2,77 (dy presje shtatëdhjetë e shtatë) pikë.**

Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore

79. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Këshilli mbështetet pikësepari në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësive dhe ushtrimin e vendimmarrjes në ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e detyrave të ngarkuara. Gjithashtu, në vlerësimin e kandidatëve për këtë komponent vlerësimi, Këshilli mban parasysh se ushtrimi i çdo detyre, funksioni dhe veprimtari profesionale, edhe kur formalisht nuk lidhet drejtpërdrejt me të drejtën/detyrimin për ushtrimin e kompetencës vendimmarrëse, gjithsesi përmban elementë që tregojnë aftësi të provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësi si edhe vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.
80. Në rastin e kandidatës Marjana Semini Tutulani, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të kësaj kandidatë për të marrë vendime dhe përgjegjësi edhe në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.
81. Këshilli vëren se kandidatja Marjana Semini Tutulani, në karrierën e saj profesionale ka ushtruar veprimtari profesionale të natyrës drejtuese dhe bashkërenduese. Qershor 2009-Korrik 2013 ka ushtruar detyrën e Drejtore e Shkollës së Magjistraturës; Tetor 2006-Qershor 2009. Përgjegjëse e Trajnimit Fillestar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shkollën e Magjistraturës; Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues *“aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore”*, Këshilli vlerëson t'i caktojë kandidatës Marjana Semini Tutulani **3,11 (tre presje njëmbtëdhjetë e një) pikë.**

Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik

82. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, sikurse edhe në përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jodiskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.
83. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Këshilli vëren se kandidatja Marjana Semini Tutulani zotëron aftësi shumë të mira për të komunikuar me kujdesin e duhur, për të dëgjuar me profesionalizëm dhe për t'u përgjigjur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.
84. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "*Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*", Këshilli vlerëson t'i caktojë kandidatës Marjana Semini Tutulani **2 (dy) pikë**.

Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale

85. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, për vetë natyrën e këtij funksioni, mënyrës së funksionimit dhe kolegjalitetit të kërkuar në veprimtarinë e vendimmarrjen kësaj Gjykate, duhet të zotërojë aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të qenë i përfshirë në punën në grup, me gjyqtarët e tjerë, këshilltarët dhe anëtarët e stafit të Gjykatës. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për t'u përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për t'u përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.
86. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Këshilli vëren se kandidatja Marjana Semini Tutulani zotëron aftësi shumë të mira për të punuar në grup dhe ka të dhëna të qarta në drejtim të organizimit të veprimtarive në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore. Prezantimi dhe dokumentet profesionale dëshmojnë se kjo kandidatë është përfshirë në mënyrë vijuese në projekte profesionale me kolegë të tjerë, vendas apo të huaj, për realizimin e veprimtarive, publikimeve shkencore dhe artikujve profesionalë.
87. Gjithashtu, zotërimi i këtyre aftësive rezulton i reflektuar edhe në vetë mënyrën e parashtrimit me shkrim të çështjeve në platformën e paraqitur, si edhe në komunikimin e bisedën e zhvilluar me Këshillin gjatë intervistës.
88. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues "*Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale*", Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatës Marjana Semini Tutulani **1 (një) pikë**.

89. Në përfundim të arsyetimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar më sipër në këtë Vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për vendet vakante në të cilat ka kandiduar, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i rezulton se kandidatja Marjana Semini Tutulani vlerësohet në total me **93,66 (nëntëdhjetë e tre pjesë gjashtëdhjetë e gjashtë) pikë**.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/ç të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidatës Marjana Semini Tutulani, me **93,66 (nëntëdhjetë e tre pjesë gjashtëdhjetë e gjashtë) Pikë** në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 16.01.2022.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Marjana Semini Tutulani.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETAR

Sokol BINAJ

